

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERIS GJIROKASTER
ZYRA E NOTER THOMA T.KACI
LAGJIA NR.1,GODINA NR.53 SARANDE
RRUGA ONHEZMI



Nr/1011 Rep

Nr/1372 Kol

STATUTI I PARTISE

“ MEGA ”

Minoriteti Etnik Grek per te Ardhmen

Sot me daten 20.mars.2010, para meje noterit Thoma T.Kaci, me seli prane Gjykates se shkalles se pare Sarande,me adrese rruga Onhezmi, godina nr.53, mu paraqiten personalish personat e poshtshenuar ne listen A, bashkelidhur , ketij Statuti, te cilet para meje noterit nenshkruan Statutin e meposhtem, te nje Partie Politike , aktiviteti i se ciles rregullohet nga dizpozitat ligjore qe funksionojne ne Republiken e Shqiperis, dhe vecanerisht ne legjislacionin Shqiptar .

PREZANTIMI,DETYRAT, EMRI, SELIA, FLAMURI DHE EMBLEMA

Neni 1.

Prezantimi

Partia MEGA “Minoriteti Etnik Grek per te Ardhmen” “Η Εθνική Ελληνική Μειονότητα για το Μέλλον” (EEMM) eshte formacioni politik, qe bashkon shtetasit shqiptare me origjine greke me qendrim brenda dhe jashte vendit, pavaresisht nga seksi dhe gjendja shoqerore, i cili shtrin veprimtarine e vete ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ky statut eshte ne perputhje me Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe me dizpozitat ligjore te vendit. Respekton dhe mbron te drejtat dhe lirite per njeriun te njohura prej konventave nderkombetare, vecanerisht per minoritetet etnike, kulturore,gjuhesore dhefetare te grupeve shoqerore dhe te individeve.

Neni 2

Detyrat e Partise

Partia ka keto detyra:

-Lufton per mbrojtjen dhe krijimin e kushteve te levrimit te lirive dhe te drejtave te njeriut ne te gjitha aspektet e jetes sipas legjislacionit nderkombetar.

-Lufton per mbrojtjen dhe krijimin e kushteve ligjore dhe shoqerore te levrimit te lirive dhe te drejtave vecanerisht te minoritetit Etnik Grek ne Shqiperi duke respektuar te drejtat dhe lirite e shumices ne vend. Ndhimon dhe kontribuon ne pershtatjen e legjislacionit te vendit me ate nderkombetar per te drejtat dhe lirite I minoriteteve, ne formimin dhe persosjen e institucioneve te specializuara per mbrojtjen e te drejtave te njeriut dhe te minoriteteteve dhe sidomos ne pjesemarjen e ketyre te fundit ne jeten shoqerore, politike, ekonomike dhe kulturore te vendit.

-Mbron dhe kultivon me tej traditen kulturore, gjuhesore dhe shoqerore te Minoritetit Etnik Grek si dhe nxit krijimin e institucioneve respective per levrimin e tyre.

-Lufton per zbatimin praktik te te drejtave nderkombetare per Minoritetet Etnike te ratifikuara nga Kuvendi i Shqiperise dhe kontribuon per pasurimin e ketij dokumentacioni nepermjet veprimtarise se saj politike ne legjislativ apo ne administrate.

-Merr persiper perfaqesimin direkt te grekeve te Shqiperise ne pushtetin qendror dhe vendor.

-Mban lidhje institucionale me institucionet nderkombetare te specifikuara per te drejtat e Minoriteteteve dhe te Drejtat e Njeriut dhe I informon rregullisht ato per ecurine e zbatimit te te drejtave.

Neni 3

Emri, sigla

Emri i partise eshte " MEGA"Minotiteti Etnik Grek per te Ardhmen

"Η Εθνική Ελληνική Μειονότητα για το Μέλλον (EEMM)

Neni 4


Selia

Selia qendrore e partise ndodhet ne Sarande ne adrese provizore Lagja Nr 1 Sarande dhe zedhenesi i Partise do te instalohet ne Tirane.

Neni 5

Vula

" MEGA" ka vulen e vete, e cila ka forme drejtekendeshit. Ne relief te vules eshte vendosur nje kapitel jonik. Poshte tij nje dege perrale dhe inicialet MEGA dhe EEMM dhe ne gjysemrrethin e siperm do te shkruhen inicialet MEGA (Minoriteti Etnik Grek per Ardhmerine" dhe EEMM (Εθνική Ελληνική Μειονότητα για το Μέλλον».





Neni 6

Emblema dhe flamuri

Partia "Minoriteti Etnik Grek per te Ardhmen" (MEGA) ka emblemen dhe flamurin e saj. Emblema e Partise paraqet nje kapitel jonik dhe nje dege paralele ku ne vazhdimesi shkruhen emertimet me shkronja kapitale MEGA dhe EEMM (te shoqeruara me emertimet e plota ne shqip dhe ne greqisht ndersa flamuri ka forme drejtekendeshi me ngjyre qyelli dhe ne mes emblema e partise.

KAPITULLI II-TE

ANETARESIMI DHE PRANIMI NE PARTI

Neni 7

Anetaresimi

Anetare te kesaj partie mund te regjistrohen te gjithë qytetaret shqiptare te moshes madhore me kombesi greke si dhe miqte dhe simpatizantet e tyre qe pranojne programin dhe statutein saj, qe paguajne rregullisht kuatizacionin dhe marrin pjese ne nje nga stukturat baze organizative te partise dhe nuk eshte anetar i nje partie tjeter.

Neni 8

Pranimi

Pranimi ne parti behet ne baze te kerkeses se secilit dhe pas votimit te hapur apo te fshehte te anetareve te seksionit ku pranohet. Moshë e pranimit eshte mbi 18 vjec.

Neni 9

Anetaret e Partise "Minoriteti Etnik Grek per te Ardhmen" (MEGA) kane dokument te njejte anetaresie, kudo qe ndodhen.

Neni 10

Personat e pranuar paguajne kuotat vjetore si dhe detyrimin financiar te pranimit.

Neni 11

Nuk pranohen ne MEGA personat:

- që perhapin ide antidemokratike dhe totalitare.
- që marrin pjese ne parti te tjera.

KAPITULLI III-te

TE DREJTAT E ANETAREVE TE MEGA-s

Neni 12

Anetari i MEGA-s ka keto te drejta:

Te marre pjese lirisht ne diskutimet, ne mbledhjet ose ne shtypin e partise, per te shfaqur mendimin e tij.

Te zgjedh dhe te zgjidhet ne te gjitha organet e Partise.

Te marre pjese ne tere veprimtarite e organizuara nga Partia.

Te propozoje dhe te propozohet kandidat perfaqesues I partise ne organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv sipas kriterëve te vendosura ne rregulloren e brendshme te Partise.

Te njihet me veprimtarine e organeve drejtuese te partise dhe te perfaqesuesve te partise ne organet e pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv.

Te beje propozime ne cdo organ te partise per problemet qe lidhen me veprimtarine e saj.

T'i drejtohet partise per te mbrojtur te drejtat e tij te ligjshme.

Te jete i pranishem ne mbledhjet e partise, ne te gjitha nivelet, kur merret nje vendim qe ka te beje me personin e tij.

Te mirret ne mbrojtje nga partia kur cenohet gate ushtrimit te aktivitetit partiak ose per shkak te bindjeve politike.

Te informohet rregullisht ne mbledhjet partiake dhe nga shtypi mbi vendimet dhe veprimtarine e organeve te Partise.

Te largohet nga partia me deshiren e tij, duke e deklaruar ate me shkrim.

Te gjithë anetaret e MEGA-s jane te barabarte ne raport me partine, pavaresisht nga funksionet qe kane brenda saj dhe gjendjes ekonomike ose pozicionit shoqeror jashte saj.

Neni 14

Largimi nga Partia

Anetari I MEGA-s mund te dale nga Partia me vullnet te vet ne cdo kohe. Per kete njofton me shkrim seksionin ku ben pjese dhe dorezon trisken e partise.

Gjithashtu behet nderprerja e anetaresise kur anetari punesohet ne sektore ku pjesemarrja ne parti ndalohet me ligj.

Perjashtohet nga partia,

- kur shkelen rende vendimet e forumeve te saj.
- kur cenohen detyrimet e caktuara ne kete statut.
- kur I shkakton dem te rendesishem funksionimit te partise.
- kur deklarohet fajtor me vendim te formes se prere te nje gjykate per veprimtari kriminale.

Sipas shkalles se pergjegjesise ndaj anetarit te Partise, merren keto masa:

- a) I hiqet verretja

b) shkarkohet nga posti qe ka perfituar nga qenia ne Parti

c) Çrregjistrohet nga Partia

Vendimi per masat e mesiperme merret ne seksionin e Partise ku ai ben pjese. Ky vendim hyn ne fuqi pasi aprovohet nga Keshilli I Kontrollit Statuor Rajonal. Anetari I perjashtuar ka te drejten e apelit brenda 15 diteve deri ne organin me te larte kolegjial, i cili ka te drejten e ndryshimit ose te anulimit te mases ndeshkimore brenda 30 diteve.

KAPITULLI IV-te STRUKTURAT ORGANIZATIVE TE MEGA-s

Neni 15

Njesia baze-seksioni

Njesia baze organizative MEGA-se eshte seksioni, I cili krijohet nga jo me pak se 20 veta. Kur numri I anetareve eshte me shume se 50 veta, atehere me deshiren e vete seksionit, ai ndahet. Seksioni I partise ne mbledhjen e pare zgjedh kryetarin dhe sekretarin, ku se bashku me te ngarkuaren e forumit te gruas dhe te ngarkuarin e forumit rinor perbejne kryesine e seksionit. Kur seksioni i kalon te 50 anetaret dhe pranon te mos ndahet, atehere mund te zgjedh edhe nje nenkryetar. Seksioni ngrihet ne baze lagjeje, fshati apo qyteti ne vartesi te anetaresise.

Neni 16

Detyrat e seksionit

Seksioni perpunon, zberthen dhe zbaton politiken e MEGA-se, mban lidhje te perditshme me anetaret dhe simpatizantet, zgjeron ndikimin e partise ne popullsi, mban lidhje me shoqatat dhe forcat e ndryshme politike ne zonen ku vepron, ne perputhje me dokumentet baze te partise, punon per zgjerimin e radheve te partise, pranon anetare te rinje, lufton per realizimin e objektivave elektorale te Partise, qe eshte detyra kryesore e seksionit, analizon veprimtarine elektorale te Partise, respekton mendimin e cdo individi brenda dhe jashte seksionit, si dhe mban qendrim ndaj secilit qe shkel normat dhe vendimet kolegjiale te partise. Propozon dhe mbron kandidaturen e kryeplakut te fshatit ose lagjes. Propozon kandidatin, ose kandidatet per keshilltare ne organet e pushtetit vendor, si perfaqesues te zones perkatese. Vlereson dhe jep mendim per veprimtarine e te zgjedhurve dhe te emeruarve qe perfaqesojne Partine. Ngre dhe jep mendime per problemet e komunitetit.

Neni 17

Funksionimi i seksionit

Organi me I larte I seksionit eshte mbledhja e seksionit, qe mbahet jo me pak se nje here ne tre muaj. Anetaret qe marrin pjese ne seksion kane vote te barabarte, ndersa mbledhja e seksionit vendos per problemet e aktivitetit dhe te drejtimit. Kryetari I seksionit zgjidhet me vote te fshehte nga anetaret e seksionit, me shumice vote nje here ne dy vjet, ndersa nenkryetari, sekretari dhe te ngarkuarit per forumin e gruas dhe te forumit rinor zgjidhen me votim te hapur.

Neni 18

Keshilli koordinues

Ne ato rrethe qe jane ngritur me shume se pese seksione ngrihet Keshilli Koordinues. I cili ben drejtimin operativ te seksioneve brenda rrethit. Keshilli Koordinues perbehet nga kryetaret e seksioneve dhe nga te zgjedhurit si drejtues ne organet e Pushtetit lokal (Komune, Bashki) dhe ka mandat 4-vjecar. Numuri i anetareve te Keshillit Drejtues eshte ne vartesi te numurit te seksioneve dhe drejtohet nga kryesia e perbere nga kryetar, n/kryetar dhe sekretar, e ngarkuara per drejtimin e Forumit te Gruas dhe i ngarkuari per drejtimin e Forumit Rinor te cilet zgjidhen me votim te fshehte ne mbledhjen e tij te pare. Keshilli koordinues, si rregull mblidhet nje here ne vit, por dhe ne menyre te detyrueshme para dhe mbas fushatave elektorale per zgjedhjet parlamendare apo per Pushtetin vendor. Keshilli koordinues zgjedh anetaret e Keshillit Rajonal te Partise ne ate numur sipas perkatesise te rrethit, zgjedh delegatet e rrethit per ne Konferencen rajonale, propozon kandidatet per drejtues te Komunave dhe te bashkive te rrethit qe mbulon, si dhe kandidatura per deputet. Jane delegate ne Konferencen rajonale ata qe propozohen si te tille nga seksionet, te zgjedhurit locale, keshilltaret e cdo niveli, perfaqesuesit e gruas, te rinise, te biznesit, te arsimit te shoqatave apo te organizatave qe ose jane krijesa te partise ose mbeshtesin programin e saj si dhe deputetet ne parlament. Raporti i perfaqesimit nga cdo seksion percaktohet nga Keshilli koordinues. Ky keshill miraton listen e kandidateve per keshilltare ne organet e pushtetit vendor. Keshilli koordinues mban lidhjet me Keshillin e Perfaqesuesve te Partise, ndjek veprimatrine e seksioneve, pranimet ne parti, organizon dhe drejton punen e Partise ne zone apo ne rreth duke bashkepunuar me te gjithet te zgjedhurit dhe mbeshtetesit e partise, organizon punen per fushatat elektorale dhe therret dhe kerkon llogari te zgjedhurit ne organet e pushtetit vendor dhe jep mendim per zgjidhjen e problemeve lokale.

Neni 19

Keshilli rajonal I Partise

Keshilli Rajonal eshte strukture organizative e Partise ne rang qarku dhe vendos per qendrimin e partise per problemet respektive te juridiksionit. Lista e anetareve te Keshillit rajonal i partise mandatohet nga Konferenca Rajonale e partise, sipas vendimeve te Keshillave Koordinuese te rretheve dhe anetaret kane mandat katervjecar. Si rregull Keshilli rajonal i Partise duhet te kete jo me pak se 35 anetare dhe lista miratohet me votim te hapur. Ne Keshillin rajonal te Partise marrin pjese pa u votuar edhe deputetet e prefektures, kryetaret e Bashkive dhe Komunave te zgjedhur si perfaqesues te partise, kryetaret e keshillave koordinues te rretheve, per aq kohe sa ushtrojne keto detyra. Ne Konferencen ne rast kondestimi per persona te vecante si anetare te Keshillit Rajonal te vendosur nga keshillat koordinues, kandidaturat e kondestuara hidhen ne votim te hapur dhe ne rast mosvotim, hidhen kandidatura e tjera per votim. Kandidatura e reja duhen te jene detyrimisht nga zona e kandidatit te kondestuar. Konferenca Rajonale e Partise si rregull mblidhet nje here ne dy vjet dhe zgjedh kryetarin me votim te fshehte, ndersa kryesia zgjidhet nga Keshilli rajonal i partise. Ne rast fushatash zgjedhore me vendim te kryesise mblidhet Konferenca rajonale e jashtezakoneshme. Po keshtu mund te mblidhet Konferenca e jashtezakoneshme me propozim te kryesise, ose te 1/3 te anetareve te Keshillit Rajonal. Keshilli rajonal mban te gjitha pergjegjesite per mbarevajtjen e punes se partise ne rajon mes dy konferencave, ndjek veprimatrine e keshillave koordinues dhe te personave te zgjedhur ne organet e pushtetit vendor, i therret dhe i kerkon llogari, organizon dhe drejton punen e Partise ne Qark, duke bashkepunuar me te gjithet te zgjedhurit dhe mbeshtetesit e partise, organizon punen per fushatat elektorale dhe jep mendim per zgjidhjen e problemeve qe lindin ne Prefektore. Jep mendim per kandidatet per deputet dhe drejtues te Komunave e Bashkive te propozuara nga

Keshillat koordinuese te rretheve. Mblidhet jo me rralle se nje here ne tre muaj me vendim te kryesise. Me propozim te 50+1 anetareve ka te drejte te kerkoje votbesim ndaj kryesise. Keshilli Rajonal krijon komisione te perhershme pune te cilat raportojne cdo 3 muaj ne mbledhjet e tij. Miraton listen e kandidateve per Keshillin Kombetar te Perfaqesuesve qe do te parashtrohet per votim ne Kongres. Si rregull numuri i kandidateve te jete me i madh se numuri i anetareve te cdo qark te percaktuar me vendim te Keshillit Kombetar te Perfaqesuesve. Zgjidh delegatet per Konferencen rajonale te Partise.

NENI 20

Kryesia e Keshillit Rajonal

Numri i anetareve te kryesise caktohet me vendim te konferences rajonale, por jo me pak se 21 veta. Kryesia, me votim te fshehte zgjedh nenkryetarit, sekretari, te ngarkuaren e Forumit te Gruas dhe te Forumit Rinor rajonale. Kryesia e Keshillit rajonal perbehet nga kryetari, nenkryetari, sekretari dhe 24 anetare. dhe ben ndarjen e punes dhe te pergjegjesive per secilin dhe ndjekin zbatimin e perditshem te detyrave. Nenkryetari dhe Sekretari zgjidhen nga Kryesia me votim te fshehte. Kryesia organizon dhe miraton ngritjen e strukturave organizative ne rajon dhe pergjigjet per zbatimin e detyrave te caktuara nga Keshilli i Perfaqesuesve dhe organet drejtuese qendrore. Organizon dhe pergjigjet per mbarvajtjen e fushatave elektorale. Bashkepunon me forcat e tjera politike si dhe raporton per punen e bere, ne Konferencen rajonale. Pergjigjet per ruajtjen dhe administrimin e materialeve dhe dokumenteve te Partise. Pregatit dhe organizon Konferencat rajonale dhe aktivitete e tjera ne shkalle qarku. Mbeshtet dhe aktivizon Forumin Rinor dhe te Gruas ne shkalle qarku dhe zgjedh me votim te hapur te ngarkuaren e Forumit te Gruas dhe te Forumit Rinor rajonale. Krijon sipas rastit komisione per te trajtuar ceshtjet e rendesishme te propagandes se partise dhe strukturat elektorale ne shkalle qarku.

KAPITULLI V

ORGANET QENDRORE DREJTUESE TE MEGA-s

Organet qendrore drejtuese te MEGA-s janë: Kongresi Programor, Këshilli Kombetar i Perfaqesuesve, Kryesia dhe Komisoni Qëndror i Kontrollit dhe respektimit të Statutit.

NENI 21

Kongresi Programor

Kongresi është organi më i lartë politik i Partisë, i cili përfaqëson të gjithë anëtarët e MEGA-s dhe shpreh vullnetin kolektiv të tyre. Ne te marrin pjese delegatet e zgjedhur nga Konferencat rajonale te partise. Anetaret e Keshillit Kombetar, Kryetaret e keshillave rajonale Deputetet, Ministra dhe drejtues te zgjedhur ne organet e Pushtetit vendor (Kryetar Bashkie dhe Komune), Kryetarja e Forumit te Gruas dhe Forumit Rinor, jane automatikisht delegate te Kongresit. Si rregull Kongresi Programor mblidhet nje here ne dy vjet, por ne raste te fushatash elektorale, apo per arsye te tjera, me vendim me 3/5 te Keshillit Kombetar te Perfaqesuesve thirret Kongresi i jahstezakoneshme. Si rregull per cdo 100 anetare duhet te jete 1 nje delegat i zgjedhur. Numuri i delegateve per cdo qark vendoset nga Keshilli Kombetar i Perfaqesuesve,

NENI 22

Detyrat dhe kopetencat e Kongresit programor

Kongresi diskuton dhe vendos vijen politike dhe programore te MEGA-s, duke miratuar Statutin, programin dhe organizimin teritorial te strukturave organizative deri ne shkalle rrethi si dhe kopetencat dhe funksionimi i tyre, mandaton Kryetarin e Partise dhe anetaret e Keshillit Kombetar te Perfaqesuesve te zgjedhur nga anetaresia, zgjedh Komisionin Qendror te Kontrollit te Brendshem dhe te Respektimit te Statutit. Miraton kandidaturat per Kryetar te Partise, i cili do te zgjidhet direkt nga anetaresia. Ne cdo rast duhet te jene me shume se dy kandidatet. Zgjedh komisionin qendror per zgjedhjet e kryetarit te Partise dhe te Keshillit Kombetar te Perfaqesuesve.

NENI 23

Vendimet e Kongresit merren me votim te hapur, me shumicen e votave te delegatëve të pranishëm në votim.

NENI 24

Kongresi drejtohet nga një presidium ku bën pjesë kryesia e partisë dhe të tjerë. Puna e Kongresit si dhe vendimet e dala prej tij quhen të ligjshme nëse në Kongres marrin pjesë më shumë se gjysma e delegatëve të mandatuar dhe nëse në votim marrin pjesë më shumë se gjysma e delegatëve të pranishëm.

NENI 25

Këshilli Kombëtar I Perfaqesuesve

Keshilli Kombetar i perfaqesuesve perbehet nga 45 anetare te zgjedhur me votim tnga anetaresia, nga Kryetaret e Keshillave Rajonale, nga deputete e ministra si dhe nga kryetare bashkie dhe komunash te zgjedhur si perfaqesues te MEGA-s, kryetarja e Forumit te Gruas dhe te Forumit Rinor per aq kohe sa ushtrojne keto detyra. Keshilli Kombetar te Perfaqesuesve drejton dhe pergjigjet per mbarvajtjen e punes se partise midis dy kongreseve. organizon dhe drejton punen per thyrjen e Kongresit te Partise, vendos per thyrjen e tij, analizon zhvillimet politike brenda dhe jashte vendit, orienton veprimtarine e deputeteve, administron jeten finaciare te Partise. Organizon dhe pergjigjet per mbarvajtjen e fushatave elektorale. Zgjedh kryesine e Partise. Miraton koalicione me Partite e tjera. Miraton kandidaturat perfundimtare per Deputet dhe per Kryetare te Komunave dhe Bashkive. Keshilli Kombetar ne mbledhjen e tij te pare zgjedh Kryetarin e Keshillit Kombetar, i cili luan dhe rolin e Sekretarit te Pergjithshem, nenkryetarin, sekretarin, dhe komisionet per cdo sektor te punes. Mbledhja e Keshillit Kombetar te perfaqesuesve mblidhet dhe drejtohet nga Kryetari i Keshilli Kombëtar zbaton vendimet e Kongresit, deri në zgjedhjet pasardhëse. Keshilli Kombëtar mund të përtërijë deri një të tretën e numrit të përgjithshëm të vetë Keshillit Kombëtar të dalë nga zgjedhjet e përgjithshme sipas renditjes se listes te ndodhur ne Komisionin Qendror Zgjedhor te Partise. Keshilli Kombetar I Perfaqesuesve thirret nga kryetari I Keshillit Kombetar gjithmone ne keshillim me Kryetarin e Partise sipas rasteve, por jo me rralle se nje here ne gjashte muaj. Mbledhjet e Keshillit Kombetar drejtohen nga Kryetari I Keshillit Kombetar.

NENI 26

Këshilli Kombëtar i MEGA-s përcakton rrugët e realizimit të vendimeve të Kongresit të partisë dhe kontrollon zbatimin e programit dhe të statutit të Partisë.

- Shqyrton çdo vit raportet për veprimtarinë e Kryesisë
- Koordinon veprimtarinë instancave me te ulta të Partisë.
- Krijon seksionet, komisionet e përhershme, përbërë nga anëtarët e Keshillit Kombëtar si nga

përfaqësues të opinionit publik për të ndihmuar arrijten e qëllimeve që ka marrë përsëpër Partia.

- Miraton buxhetin vjetor të Partisë, planet dhe veprimtaritë kryesore, si dhe programet shumëvjeçare.
- Shqyrton dhe vlerëson aktivitetin Kryetarit dhe të Kryesisë së Partisë.
- Vlerëson punën e deputetëve, ministrave, funksionarëve të lartë të shtetit, të pushtetit lokal dhe të funksionarëve që janë kandiduar nga MEGA.

NENI 27

Kryesia

Organi Ekzekutiv i Partisë është Kryesia që përbëhet nga 21 vetë të dalë nga votimi i fshehtë në Kongres. Anëtarët e kryesisë janë drejtëpërdrejtë anëtarë të Këshillit Kombëtar, e cila në periudhën mes dy mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të Perfaqësuesve është organ drejtues. Kryesia e Partisë "MEGA" mbledhet jo më pak se një herë në 2 muaj.

- Drejton zbatimin e vendimeve të Kongresit, të mbledhjeve të Këshillit Kombëtar të perfaqësuesve, të punës së seksioneve dhe të Komisioneve të përhershme.
- Drejton punët e përditshme të Partisë dhe veprimtarinë e seksioneve ose këshillave të krijuara pranë Kryesisë.
- Harton projektet e buxheteve vjetore të Partisë, projektet e planeve të veprimtarisë kryesore dhe programeve të tjera.
- Miraton rregulloret e seksioneve, të komisioneve të përheshëm dhe të grupeve të krijuara pranë Këshillit Kombëtar të Perfaqësuesve.
- Thërret mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Perfaqësuesve.
- Përgatit lëndët për diskutim në mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Perfaqësuesve dhe në veprimet e tjera kombëtare të Partisë.
- Vendos për thirrjen e Konferencës Programore si dhe mund të caktojë organe drejtuese të përkohshme të Partisë neper rajone
- Merr vendim për shpenzimin e mjeteve financiare, si dhe për sigurimin e veprimeve organizative të Partisë.
- Në emër të Partisë, përmbyll aktet, bën marrëveshje, jep garanci, hap dhe mbyll llogaritë në degët përkatëse të Bankës së Shtetit dhe administron pasurinë e Partisë brenda kufijve që cakton ligji dhe në lidhje me Statutin e Partisë.
- Miraton modelet e vetme të taserës së Partisë dhe vulën për degët e saj.
- Vendimet e saj quhen të ligjshme kur në votim (të hapur ose të fshehtë) marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve (Kryesisë).

NENI 28

Kryesia vendos për bashkëpunim me partitë, shoqatat e forumet për çështje të ndryshme. Vetëm për probleme që kanë të bëjnë me vijën politike thërret Këshillin Kombëtar të Perfaqësuesve për të vendosur. Harton taktikat elektorale, programet elektorale si dhe listat e kandidaturave që dalin nga mbledhjet e zgjeruara me anetaresine neper njesi administrative.

- Miraton apo shkarkon kryeredaktorin si dhe kolegjin e redaksisë.
- Merr vendime për çështje të rëndësishme politike mbi qëndrime ose deklarime të pozicionit të saj.

NENI 29

Kryesia zgjedh me votim të fshehtë dhe me shumicë votash sekretarët e partisë, atë organizativ, atë të marrdhënieve publike, atë të marrdhënieve me jashtë, të problemeve ekonomike, si dhe zëdhënësin e Partisë.

Me propozim të 1/3 të anëtarëve të saj, me shumicë votash, me votim të fshehtë, me

pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të kryesisë mund të shkarkojë secilin nga sekretarët e Partisë dhe t'i zëvendësojë ata me të rinj.

NENI 30

Komisioni Qëndror i Kontrollit dhe Respektimit të Statutit.

Kontrollon zbatimin e Statutit të Partisë, të vendimeve të Kongresit, të Këshillit Kombëtar, të Kryesisë si dhe të dokumenteve bazë të Partisë.
- Kontrollon diskutimin e kërkesave, deklaratave, ankesave që u drejtohen organeve qendrore.
- Kontrollon veprimtarinë ekonomiko-financiare dhe zbatimin e drejtë të buxhetit të Partisë.
Perbehet prej 9 vetash me preference specialiste ne ekonomi, jurispedence dhe zgjidhen nga Kongresi.

NENI 31

Komisioni Qëndror i Kontrollit dhe i Respektimit të Statutit është organi qendror disiplinor i partisë. Ankimet për përjashtimet, masat disiplinore ose edhe për keqinterpretimin e Statutit, apo për veprimet antistatutore në mënyrë përfundimtare realizohet në Komisionet e Kontrollit dhe të respektimit të Statutit. Vendimi i Komisionit Qëndror është i formës së prerë.

NENI 32

Komisioni Qëndror i Kontrollit dhe respektimit të Statutit zgjidhet nga Kongresi i Partisë dhe përbëhet nga Kryetari i tij, zv/kryetari dhe 3 anëtarë.
Komisioni i Statutit interpreton Statutin dhe aktet e tjera normative të Partisë, përgatit propozimet për ndryshime, plotësime, saktësime të Statutit, kujdeset për ligjshmërinë e vendimeve të organeve të Partisë.
Komisioni i Statutit përgatit ndryshimet e propozuara të Statutit ose projektstatutit dhe ua dërgon për shqyrtim organeve drejtuese të Partisë dhe degëve. Mbi bazën e mendimeve të vjelura mbi propozimet e bëra, Komisioni i Statutit përgatit propozimet përfundimtare për projektstatutin. Ky projekt i paraqitet për miratim Kongresit, Këshillit Kombëtar ose Aktivit Kombëtar, të vetmit organe të partisë që kanë të drejtën për të miratuar ndryshimet në Statutin e Partisë.

KAPITULLI VI

ORGANET E ADMINISTRIMIT DHE KONTROLLIT TE ZGJEDHJEVE BRENDA PARTISE

NENI 33

Komisioni zgjedhor

Komisioni Zgjedhor I MEGAS-s eshte organi qe drejton, kontrollon zgjedhjet brenda Partise me parimin "nje anetar-nje vote", per Kryetarin e Partise dhe per Perfaqesuesit ne Keshillin Kombetar.

Komisioni Zgjedhor Qendror I Partise perbehet nga 7 veta dhe 1 njeiti raport mbahet edhe ne rajon apo ne njesi me te vogla administrative.

Anetaret e Komisionit Zgjedhor zgjidhen ne Kongresin e Partise me shumice votash dhe afati i veprimtarise se tyre zgjatet edhe 6 muaj pas mbarimit te legjislatures se Kryetarit. Asnje nga

anetaret e komisionit nuk mund te zgjidhet ne asnje post drejtues te partise. Duhet te jene personalitete me pasterti morale dhe asnjanes.

Komisioni Zgjedhor Qendror harton dhe miraton ne Keshillin Kombetar te perfaqesuesve te gjithë dokumentacionin ligjor per zgjedhjet, pergatit fletet e votimit dhe gjithë llogjistiken mbeshtetese dhe emerone anetaret e komisioneve vendore te propozuara nga kandidatet si dhe listen shumeemere te perfaqesuesit.

Pas mbarimit te zgjedhjeve kontrollon legjitimitetin e tyre dhe shpall rezultatet.

Komisioni Zgjedhor Qendror dhe ato vendore ushtrojne veprimtarine e tyre te pavarur ne baze te "Rregullores Zgjedhore" qe miratohet qe ne Kongresin e pare Programor te Partise.

NENI 34

Kryetari I Partise

Kryetari I Partise zgjidhet me parimin nje anetar nje vote. Zgjedhjet per Kryetarin e Partise dhe per Perfaqesuesit ne Keshillin Kombetar te Partise behen te fshehta, ne nje dite pushimi ne te gjitha seksionet e Partise. Ne zgjedhje marrin pjese te gjithë anetaret dhe simpatizantet te regjistruar deri nje muaj me pare se te zhvillohen zgjedhjet.

NENI 35

Kryetari i Partise perfaqeson ligjerisht Partine brenda dhe jashte vendit dhe vepron ne emër te saj. Kryetari i Partise drejton aksionet politiko-organizative ne perputhje me vijen e Kongresit dhe vendimet e Keshillit Kombetar te Perfaqesuesve.
Bën pjesë në të gjitha organet qendrore të Partisë
Emëron dhe shkarkon çdo punonjës në qendër të cilët nuk janë të zgjedhur nga forume partiake.
Kontsitoun departamentet, zyrat dhe organizon aktivitetin e tyre në këshillim me Kryesinë e Partisë.
Angazhon anëtarët e kryesisë dhe funksionarët e tjerë të aparatit të partisë me punët partiake.
Cakton delegacionet për kontaktet me jashtë dhe ndërpartiake brenda vendit.
Kryetari i Partisë nuk zgjidhet më shumë se dy herë radhazi.

KAPITULLI VII

Rinia dhe Gruaja Partise "Minoriteti Etnik Grek per te Ardhmen" MEGA

NENI 36

Rinia dhe Gruaja e partise janë pjesë integrale e Partise MEGA. Ato në planin organizativ janë të përfshira në strukturat e Partise. Për problemet specifike të tyre ato organizohet dhe funksionojnë sipas statuteve të tyre të aprovuara në organet e tyre.

NENI 37

Programi, Statuti dhe aktet e tjera normative të MEGA-s janë të detyrueshme për Rininë dhe për Gruan e Partise.

NENI 38

[This section contains numerous handwritten signatures in blue ink, some overlapping the text of Article 38. The signatures are scattered across the bottom half of the page, with some appearing to be official or representative signatures.]

Rinia dhe Gruaja e MEGA-s përfaqësohet në të gjitha organet drejtuese lokale ose qendrore të MEGA-s . Norma e përfaqësimit në këto organe drejtuese përcaktohet nga raporti që ato zënë në efektivin Partise.

KAPITULLI VIII

Deputetët dhe përfaqësuesit në pushtetin lokal

NENI 39

Deputetet janë automatikisht anetare të kryesise së Partise.

- Partia "MEGA" bën politikën e vet në organet e pushtetit shtetëror përmes përfaqësuesve të vet të zgjedhur në këto organe.
- Deputetët e MEGA-s të zgjedhur në Parlamentin Shqiptar përbëjnë grupin parlamentar.
- Grupi parlamentar është i detyruar të respektojë politikën e Partisë dhe të zbatojë vendimet e organeve drejtuese të saj.

KAPITULLI IX

Bashkëpunimi me partitë, Shoqatat e Forumet.

NENI 40

Partia MEGA bashkëpunon me të gjitha partitë politike, shoqata dhe forumet me orientim politik të njëjtë me të saj. Realizon lidhje ndërkombëtare të qëndrueshme me parti, shoqata politike ose bashkësi politike që janë afër aspiratave, idealeve dhe iniciativave politike të Partise MEGA.

Shtypi dhe mjetet e informacionit

NENI 41

Organet e shtypit dhe mjetet e tjera të informimit publik të Partise MEGA mbështesin punën e tyre në normat e Statutit dhe në programin e partisë. Informacionet në media, do jepen me vendime Kolegjiale. Ato ruajnë të drejtën për të qenë të lirë në dhënien e informacioneve e në shprehjen e lirë të mendimeve. Mjetet e komunikimit masiv të Partise do të jepen në dy gjuhë: gjuhen shqipe dhe gjuhen greke.

Mjetet financiare të Partisë

NENI 42

Të ardhurat financiare të Partisë përbëhen nga :

- Kuotat e partisë
- Buxheti i Shtetit, sipas ligjit për financimin e partive politike.
- Të ardhura nga shfrytëzimi i pasurisë së tundshme dhe të patundshme të Partisë.
- Të ardhura nga ndërmarrjet e Partisë
- Të ardhura nga veprimtaria botuese e Partisë
- Nga ndihmat e dhuruara nga anëtarët dhe simpatizantët e Partisë.
- Mjetet e dhuruara me testament Partisë
- Të ardhurat nga veprimtari me pagesë.

-Të ardhura të tjera në përputhje me ligjet e shtetit. Kontribute vullnetare të qytetarëve, institucioneve, ndërmarrjeve, organizatave, etj.

NENI 43

Rezultatet financiare dhe buxheti vjetor i partisë MEGA shqyrtohen e miratohen në Këshillin Kombëtar të Perfaqësuesve.

NENI 44

Pranë Këshillit Kombëtar të Perfaqësuesve vepron Komisioni Ekonomik, i cili administron burimet financiare e materiale të Partisë dhe përgjigjet për përdorimin e tyre. Komisioni ka të drejtë të kërkojë llogari për problemet ekonomike e financiare në të gjitha strukturat e Partisë.

NENI 45

Për kontrollin ekonomik e financiar është i ngarkuar Komisioni i Kontrollit të Brendshëm dhe i Respektimit të Statutit në rajon e në qendër.

NENI 46

Anëtarët e Komisionit të Kontrollit të Brendshëm dhe Respektimit të Statutit nuk mund të jenë në asnjë pozicion tjetër në organet drejtuese të partisë MEGA. Asnjëri nuk mund të jetë anëtar i përheshëm i Komisionit të Kontrollit të Brendshëm dhe Respektimit të Statutit.

NENI 47

Partia dhe fondet financiare të saj janë të çliruara nga taksat.

KAPITULLI X

Dispozita kalimtare

Grupi Drejtues i Perkohshëm

Neni 48

Komisioni nismetar për krijimin e partisë zgjedh grupin drejtues të perkohshëm të Partisë me kryetar, sekretar, zedhenes shtypi dhe sekretar organizativ, financiarin, të cilët do të merren me:

-regjistrimin e Partisë MEGA në gjykatën e shkalës së Parë të Tiranës.

-përgatitjen e Kongresit të parë Organizativ të Partisë i cili do të zhvillohet 45 ditë pas regjistrimit të Partisë.

-krijimin e seksioneve në baze

-veprimtarinë financiare

-komunikimin në media dhe në politike.

Neni 49

Kongresi i Pare Organizativ i Partise do te zhvillohet me pjesemarrjen e te gjithe themeluesve, personalitete te spikatura te Minoritetit Etnik ne te gjitha fushat dhe perfaqesues te seksioneve te Partise ne te gjithe shtrirjen e saj dhe

-miraton Rregulloren Elektorale te Partise per zgjedhjen e te gjithe organeve te Partise, per zgjedhjen e kryetarit dhe te Perfaqesuesve me parimin "nje anetar nje vote".

-zgjedh Komisionin Qendror Zgjedhor per zhvillimin e zgjedhjeve.

-percakton daten e zgjedhjeve te para.

-zgjedh komisionet e perkohshme per hartimin e politikave te specifikuara per cdo sektor te problematikave qe percaktohen ne program.

-zgjedh Komisionin e Perkohshem te Kontrollit te Brendshem dhe te Respektimit te Statutit

-zgjedh Komisionin e Transparences Ekonomike dhe miraton kryefinancierin e Partise.



KAPITULLI XI

Dispozita të ndryshme dhe të fundit.

NENI 50

Programi dhe Statuti i Partisë janë të hapur për çdo ndryshim që e kërkon nevoja në rritjen e forcimit të Partisë.

NENI 51

Partia Minoriteti Etnik Grek per te Ardhmen MEGA është person juridik.

NENI 52

Veprimtaria e Partise Minoriteti Etnik Grek per te Ardhmen MEGA mund të ndërpritet me miratimin e 2/3 të anëtarëve të partisë të marrë në referendum partiak. Me këtë rast të gjitha mjetet financiare dhe pasuria që mbetet mbas likuidimit të saj t'i kalojnë ne favor te komunitetit qe mbeshteti Partine. Kjo behet me vendim te Kongresit.

NENI 53

Dispozitat e fundit

Kongresi i pare Programor i MEGA-s drejtohet nga Grupi Drejtues i Partise i zgjedhur nga komisioni nismetar per krijimin e partise.

NENI 54

Ky Statut hyn në fuqi mbas miratimit të tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

Ky akt u redaktua nga une noteri, dhe pasi ju lexua paleve me ze te larte te cilet e gjeten ate ne pajtim me vullnetin e tyre te lirie e te shpehur ne kete akt, e nenshkruan ate rregullisht para meje noterit, dhe une noteri legalizoj nenshkrimet e tyre ne baze te ligjes dhe per te gjitha efektet e saj ligjor.

Multiple handwritten signatures in blue ink, including names like 'B. B. B.', 'A. T.', and others, covering the bottom half of the page.